VENDIM
Nr. 67, datë 10.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha,	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 5.10.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 47 akti, që i përket:

KËRKUES: Agron Laçaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr.199, datë 17.4.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr.110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1/2, 43, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, Agron Laçaj, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga dokumentet të cilat shoqërojnë kërkesën rezulton se kërkuesi është gjykuar për veprat penale "Vrasje me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje".

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 226, datë 25.7.2000, ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale "Vrasje me dashje", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale "Vrasje me dashje", parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje e armëve luftarake", parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, përfundimisht dënimin e të pandehurit Agron Lan Laçaj me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim."*.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.159, datë 15.12.2000, ka vendosur: *"Prishjen e vendimin nr. 226, datë 25.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues"*.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, ka vendosur: *"Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A.L. për veprën penale "Vrasje" së shtetasit L. H., parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (KP). Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A.L. për veprën penale*

"Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake", parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, sipas nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal në burg të caktuar ndaj të pandehurit A. L., të caktuar me vendimin nr. 2, datë 2.3.2000, të Gjykatës së Apelit Shkodër.".

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 199, datë 17.4.2014, ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë mënyrë: Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale "Vrasje me dashje" në dëm të shtetasit S. R., parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale "Vrasje me dashje" në dëm të shtetasit L. H., parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake", parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimin përfundimisht të të pandehurit A. L. me 25 vjet burgim.".*

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

7. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

7.1 Është shkelur e drejta për t'u mos u deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme dhe parimi i kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Apelit Shkodër ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u dhënë vlerë provave të marra në mënyrë të paligjshme, të cilat gjykata e rrethit i ka deklaruar si të marra në shkelje të ndalimeve ligjore.

7.2 Është cenuar e drejta e aksesit dhe e drejta e mbrojtjes, pasi Gjykata e Apelit Shkodër nuk i ka komunikuar kërkuesit ankimin e bërë nga prokurori, si dhe nuk e ka njoftuar atë për datën dhe orën e seancës gjyqësore.

7.3 Është cenuar parimi i paanshmërisë dhe barazisë së armëve, pasi gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, mbrojtësi i kërkuesit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve V. V. dhe L. H., kërkesë e cila është rrëzuar nga një tjetër kolegj.

7.4 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit të bërë nga mbrojtja.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

8.1 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar, pasi nga materialet e dosjes konstatohet se kërkuesi ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet, kundërshtimet dhe provat e tij. Ai është përfaqësuar gjatë gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër nga avokati S. A., i zgjedhur nga vetë kërkuesi.

8.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë dhe së drejtës së aksesit në gjykim, rezulton se Kolegji Penal, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Vendimi i këtij kolegji përmban palët, shkaqet e rekursit dhe të gjitha pretendimet e kërkuesit. Në fund, kolegji ka konkluduar se nuk ka shkaqe për të pranuar shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore, gjë e cila është tërësisht në juridiksionin e atij kolegji.

8.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të së drejtës për t'u mbrojtur. Nga verifikimi i fashikullit të gjykimit nga Gjykata e Apelit Shkodër, rezulton se kjo gjykatë ka kryer të gjitha njoftimet, në respektim të ligjit procedural penal. Për çdo seancë i ka dërguar njoftimet avokatit S. A., të caktuar nga vetë kërkuesi, si dhe i ka dërguar njoftimet kërkuesit nëpërmjet oficerit të Policisë Gjyqësore.

8.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, mënyra e vlerësimit

të provave të administruara në gjykim nga ana e gjyqtarit apo mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit jo vetëm që janë çështje që nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, por ato nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur këtë pretendim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis* vërehet se vendimi i fundit i dhënë për kërkuesin është ai i datës 14.1.2016, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërsa kërkesa është paraqitur pranë Gjykatës në datën 31.5.2017. Nëpërmjet letrës shoqëruese dhe pagesës së postës nr. 0115901, datë 28.2.2017, kërkuesi provon se kërkesën e tij e ka dorëzuar në zyrën postare "TNT" në datën 28.2.2017, periudhë kjo në të cilën kanë qenë në fuqi dispozitat e vjetra ligjore, konkretisht neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikonte paraqitjen e kërkesës brenda afatit 2-vjeçar. Për sa më sipër, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* për t'iu drejtuar Gjykatës.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

11. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe materialeve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se kërkuesi pretendimet e tij për cenimin e së drejtës së aksesit dhe asaj për t'u mbrojtur, si dhe për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe të barazisë së armëve nuk i ka ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mos shteruar kështu mjetet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës. Për këto arsye, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

12. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit Shkodër ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u dhënë vlerë provave të marra në mënyrë të paligjshme, të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka deklaruar si të marra në shkelje të ligjit.

13. Gjykata ka theksuar se mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Në bazë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatat e kanë për detyrë të vlerësojnë në tërësi nëse procedurat lidhur me mënyrën se si janë siguruar provat kanë qenë të drejta. Nisur nga këto qëndrime të evidentuara në jurisprudencën europiane, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj,

duke evidentuar dallimin që ekziston në një proces ligjor ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, si dhe fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*shih vendimin nr. 7, datë 27.4.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, vëren se në rastin konkret gjykata të niveleve të ndryshme kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes në ngarkim të kërkuesit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se: "*Nga procesverbali nuk rezulton që dëshmitarit Lan Laçaj, megjithëse ishte babai i të pandehurit, dhe sipas nenit 16 dhe 158 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kishte të drejtën për të mos dëshmuar, nga ana e policisë gjyqësore nuk i është marrë pëlqimi në mënyrë të shprehur nëse dëshiron apo jo të japë deklarime lidhur me faktin. Pra, nuk rezulton që t'i jetë bërë me dije shprehimisht se ka të drejtë të mos dëshmojë dhe pastaj t'i merret shprehimisht pëlqimi duke u pasqyruar në procesverbal. Gjykata çmon se ky veprim procedural është realizuar në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji dhe si rrjedhojë rezultati i dalë prej saj është i papërdorshëm... Nga procesverbali rezulton që dëshmitarit Kreshnik Laçaj, megjithëse ishte vëllai i të pandehurit, dhe sipas nenit 16 dhe 158 të KPP-së, kishte të drejtën për të mos dëshmuar, nga ana e policisë gjyqësore nuk i është marrë pëlqimi në mënyrë të shprehur nëse dëshiron apo jo të japë deklarime lidhur me faktin. Gjykata çmon se ky veprim procedural është realizuar në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji dhe si rrjedhojë rezultati i dalë prej saj është i papërdorshëm. Rezulton që të pavlefshme janë vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesa për gjykim dhe vendimi për marrjen e personit si të pandehur*", duke vendosur në përfundim të gjykimit deklarimin të pafajshëm të kërkuesit. Në ndryshim nga sa më sipër, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke deklaruar fajtor kërkuesin, si dhe duke vlerësuar se: "*Në gjykim janë administruar thëniet e dëshmitarit Kreshnik Laçaj, vëllai i të pandehurit Agron Laçaj, të marra konform nenit 369 të KPP-së... Këto deklarime vlerësohen nga gjykata për sa i përket autorësisë së vrasjes, për shkak se deklarimet e këtij dëshmitari janë marrë në respektim dhe zbatim të nenit 158 të KPP-së, ku dëshmitarit që ka lidhje gjinore me të pandehurin i bëhet e ditur e drejta që ka për të mos dëshmuar dhe ky dëshmitar me vullnetin e tij ka dhënë deklarimet e datës 22.12.1999. Mos pasqyrimi i nenit përkatës nuk e bën dëshminë të pavlefshme. Deklarimet e këtij dëshmitari të bëra në hetimet paraprake, duke u marrë në zbatim të nenit 369 të KKP-së, kthehen në provë dhe shqyrtohen në tërësi me provat e tjera të marra në këtë gjykim për sa i përket provueshmërisë së autorit, por vlerësohen të pabesueshme thëniet e tij për sa i përket mekanizmit të vrasjes, ku ky dëshmitar është përpjekur që ta pozicionojë të pandehurin si vrasje e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Sa i përket arsyetimit të gjykatës për pavlefshmëri të akteve të procedimit penal lidhur me përfundimet e hetimeve, njoftimin e kërkesës për gjykim, njoftimit të akuzës, vlerësimit të thënieve të dëshmitarëve Lal Laçaj e Kreshnik Laçaj, të bëra gjatë hetimeve paraprake, Gjykata e Apelit i gjen ato të drejta vetëm për sa i përket dëshmitarit Lan Laçaj, të cilat nuk janë marrë konform nenit 158 të KPP-së.*".

15. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit është e paqartë, pasi nuk shpjegon se pse ka pranuar deklarimet e bëra nga dëshmitari Kreshnik Laçaj (vëllai i kërkuesit) dhe nuk ka pranuar deklarimet e bëra nga dëshmitari Lan Laçaj (babi i kërkuesit), konstatim të cilin duhet ta kishte bërë dhe të ishte shprehur Gjykata e Lartë.

16. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese

në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimin nr. 30, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në jurisprudencën kushtetuese, çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se, edhe pse në rekurs kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit Shkodër i ka bërë një vlerësim të ndryshëm provave nga vlerësimi që ka bërë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

19. Gjykata vlerëson se, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës* Kushtetuese). Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë ngre dyshime edhe në lidhje me respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

21. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej për to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit.

22. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen konkrete Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, duke mos ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Agron Laçaj jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Sipas shumicës, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar jo vetëm në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

3. Duke qëndruar në linjë me qëndrimet e mia në pakicë në çështje të së njëjtës natyrë, edhe në rastin konkret dua të ritheksoj se sipas nenit 433 të KPP-së është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojë të drejtat e tjera të tij substanciale.

4. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit, ajo nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se kolegji ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi. Ky proces është vënë në dyshim nga Gjykata vetëm në rastin kur këto vendime nuk përmbajnë shkaqet e ngritura në rekurs, çka, sipas saj, përbën cenim të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë parim, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim *(shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Bazuar në vendimet e kundërshtuara rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar të pafajshëm kërkuesin, duke vlerësuar se disa nga provat e administruara gjatë fazës së

hetimeve paraprake janë marrë në mosrespektim të kërkesave ligjore, ndaj i ka konsideruar ato të pavlefshme. Në ndryshim nga kjo gjykatë, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se thjesht mospasqyrimi i dispozitës ligjore në dëshmi nuk e bën atë të pavlefshme dhe se deklarimet e bëra në hetimet paraprake kthehen në provë dhe shqyrtohen në tërësi me provat e tjera të marra në këtë gjykim për sa i përket provueshmërisë së autorit. Po ashtu, Gjykata e Apelit nuk ka gjetur të drejtë as arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë për pavlefshmëri të disa akteve të procedimit penal. Në përfundim të gjykimit, ajo gjykatë ka dhënë një vendim të arsyetuar në lidhje me qëndrimin e mbajtur prej saj, për sa i takon pavlefshmërisë së dëshmive dhe akteve procedurale, dhe ka arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesit bazuar në vlerësimin e shqyrtimin tërësor të të gjitha provave të administruara në gjykim, si dhe duke argumentuar qëndrimin e saj.

6. Për rrjedhojë, për sa kohë që në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit nuk vërehet asnjë shkelje që mund ta cenojë atë, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë nuk mund të vihet në dyshim. Gjykata e Lartë, duke vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, ka vlerësuar se ato janë të pabazuara dhe ka vendosur mospranim e rekursit.

7. Për sa më sipër, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga Agron Laçaj është e pabazuar dhe se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e saj.

Anëtare: Altina Xhoxhaj